



Primitur / Dorezuar Prilbjen / Prilato Received / Delivered	04. 02	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Orgj / Unit	Nr Pror Br Pror Pror No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHIK	565/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1230/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Eshref Shabani dhe Jeton Koca-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bektashi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1230/2021 të datës 29.12.2021, e parashtruar nga ankuesi me adresë

Komuna e Drenasit, kundër organit të punësimit/ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "kontestim konkursi" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

SHPALLET jo kompetent Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për të vendosur për ankesën me numër A.nr.1230/2021 të datës 29.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 29.12.2021 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër të protokollit 6380/2021, me pretendimin ankimor kundër procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Masën Agro-Mjedis-Klimë dhe Bujqësi Organike si dhe Ngritje dhe Mbrojtje të Pyjeve" në konkursin e shpallur të datës 10.08.2021 nga Banka Botërore për Projektin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Më datë 03.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, faqe 1/1.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e datës 29.12.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aplikimi i ankuesit i datës 07.12.2021; E-mail-at e datave 21.10.2021, 20.10.2021, 14.10.2021, 13.10.2021, 10.12.2021, 07.12.2021, 24.08.2021, Kërkesë për shprehje interesit; Përshkrimi i punës; Njoftimi i datës 11.08.2021 si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoje se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi *sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ankohet kundër anulimit të konkursit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Masën dhe Bujqësi Organike si dhe Ngritje dhe Mbrojtje të Pyjeve" në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural", i cili pretendon se kjo është pozitë është pozite e rregullt e përhershme e shërbimit civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2022 të MBPZHR e cila ka njoftuar lidhur me kete procedure te rekrutimit citoj si ne vijim "të gjitha procedurat i ka zhvilluar Banka Botërore dhe Divizioni i Burimeve Njerëzore-MBPZHR nuk posedon asnjë dokument rreth këtij rasti", andaj Kolegji bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 i cili përcakton se „Institucion i administratës shtetërore - është Zyra e Kryeministrit, një ministri, një agjenci ekzekutive, një agjenci rregullatore, duke përfshirë degët lokale të tyre; ndërsa me nën paragrafin 1.2 përcaktohet se „Institucion tjetër shtetëror - është administrata e Kuvendit, administrata e Presidentit, administrata e një institucioni të sistemit të drejtësisë, e një institucioni të pavarur, e një agjencie të pavarur apo e një komune“, si dhe nenit 34 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: 1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 3. Konkurrimi organizohet nga DMZP për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore për çdo institucion tjetër (në tekstin në vijim: njësia përgjegjëse).

Kolegji, në kuptim të dispozitave të lartcekura ka konstatuar se pranimi në Shërbimin Civil behet përmes procedurës se konkurrimit, e cila organizohet nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për institucionet e administratës shtetërore dhe nga Njësia e Burimeve Njerëzore, për çdo institucion tjetër.

Andaj, meqenëse se në shkresa të lëndës nuk ka asnjë provë që dëshmon se kjo procedurë e rekrutimit është zhvilluar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, dhe duke marr parasysh përgjigjen në ankesë të datës 03.02.2022 të Divizionit për Burime Njerëzore pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ku ceket se: Këtë procedurë e ka zhvilluar Banka Botërore në kuadër të MBPZHR, mirëpo Divizioni i Burimeve Njerëzore



nuk posedon asnjë dokumentacion, Kolegji konstaton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil dhe as kandidatit për pranim në Shërbimin Civil, sepse pranimi në Shërbimin Civil mund të bëhet vetëm përmes konkursit të organizuar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (për institucionet e administratës shtetërore), dhe Njësia e Burimeve Njerëzore (për çdo institucion tjetër shtetëror).


Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli shqyrton dhe merr vendime për *ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil*, si dhe duke marr parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo të kandidatit për pranim në shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1230/2021 të datës 29.12.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBYMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1230/2021

Valentina KAÇANDOLLI BEKTESHI


Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI


Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Njësies së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;